

STATUTI
BUFF SOLUTIONS SHPK
SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;

Kreu I

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

1. Më datë **01/11/2025 (01 Nëntor 2025)**, themeluesit, kanë krijuar një shoqëri me Emër **BUFF Solutions Shpk** përgjegjësi të kufizuar dhe me Emër Tregtar **BUFF Solutions Shpk**.
2. Themeluesi i shoqërisë është:
 - **Z. Enid Mero**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 08/03/1991, banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i dokumentit të identitetit tip karte me Nr. Personal J10308083B, i lëshuar nga MPB në datën 17/07/2019.
 - **Z. Oni Brahimaj**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 10/11/1987, banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i dokumentit të identitetit tip karte me Nr. Personal I71110044P, i lëshuar nga MPB në datën 16/10/2020.

Neni 2:

Objekti

Shoqëria do të ushtrojë veprimtari tregtare në fushën e tregtisë elektronike (E-Commerce), shërbimeve të ndërmjetësimit, logjistikës urbane, marketingut dixhital dhe teknologjisë së informacionit, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.



(I) Aktivitetet kryesore

Shoqëria do të kryejë aktivitetet e mëposhtme:

- Shitje me pakicë nëpërmjet aplikacioneve ose në internet, si dhe çdo formë tjetër tregtie me pakicë të kryer jashtë dyqanit fizik.
- Shërbime ndërmjetësimi, duke vepruar si ndërmjetës mes konsumatorëve fundorë dhe bizneseve (B2C), ose ndërmjet bizneseve (B2B), përfshirë, ndër të tjera, restorante, kafene, markete, farmaci, dyqane lulesh, dhuratash, këpucësh, veshjesh, produkteve ushqimore apo për kafshët shtëpiake, si dhe çdo subjekt tjetër tregtar që ofron produkte ose shërbime në treg.
- Shërbime postare dhe të dërgesës për porosi të kryera përmes platformës online të Shoqërisë, duke përdorur mjete transporti për distanca të shkurtra brenda qyteteve ose rretheve përreth.
- Zhvillimin, prodhimin, importin, blerjen, shitjen, rishitjen dhe marketingun e produkteve ushqimore dhe të çdo kategorie tjetër produktesh të lejuara me ligj, si dhe ofrimin e shërbimeve logjistike dhe të shpërndarjes në nivel lokal dhe kombëtar.
- Zhvillimin, krijimin, administrimin dhe operimin e platformave elektronike (faqe interneti, aplikacione mobile, marketplace) për shitje dhe/ose ndërmjetësim tregtar nëpërmjet internetit.
- Ofrimin e shërbimeve të marketingut, promovimit dhe konsulencës për bizneset e lidhura me platformën e Shoqërisë ose me platforma partnere përfshirë shërbime infrastrukture për korrierë dhe subjekte bashkëpunëtoare.

(II) Aktivitetet plotësuese dhe mbështetëse

Për realizimin e objektit të mësipërm, Shoqëria mund të ushtrojë veprimtari ndihmëse dhe plotësuese si më poshtë:

- Shërbime të marketingut dixhital, menaxhim rrjetesh sociale, krijim përmbajtjeje (content creation), SEO/SEM, reklama të paguara, dizajn grafik dhe zhvillim marke (branding).
- Shërbime të zhvillimit dhe mirëmbajtjes së faqeve web, aplikacioneve mobile, platformave të menaxhimit të porosive dhe sistemeve të integruara dixhitale (CRM, ERP, CMS).
- Konsulencë në fushën e teknologjisë së informacionit, transformimit dixhital, automatizimit.
- Menaxhim magazinash, depozitash, qendrave të shpërndarjes dhe shërbimeve “pick & pack”, si dhe implementim të zgjidhjeve logjistike inteligjente.



Faqe 2

- Ofrim trajnimesh dhe asistencë teknike për bizneset në fushën e tregtisë elektronike dhe menaxhimit të platformave dixhitale.

(III) Veprimtari të përgjithshme tregtare e financiare

Me qëllim përmbushjen e objektit të saj, Shoqëria ka të drejtë:

- Të lidhë çdo lloj kontrate ose marrëveshjeje me persona fizikë apo juridikë, entitete private ose publike, shoqëri, institucione shtetërore ose organizata vendase e të huaja;
- Të themelojë degë, përfaqësi, filiale ose agjenci në Shqipëri ose jashtë saj;
- Të marrë pjesë në shoqëri shqiptare apo të huaja, si dhe në bashkime shoqërisht, “joint venture” ose forma të tjera bashkëpunimi që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me atë të Shoqërisë;
- Të marrë hua, të pranojë ose të japë garanci personale apo reale, të marrë përsipër detyrime dhe të lëshojë garanci të tjera kolaterale;
- Të ndërmarrë çdo veprim tregtar, industrial apo financiar që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me qëllimin e shoqërisë dhe që kontribuon në realizimin e tij;
- Të kryejë, në mënyrë plotësuese dhe rastësore, çdo transaksion mbi pasuri të luajtshme ose të paluajtshme, të nevojshme ose të përshtatshme për arritjen e qëllimeve të saj;
- Të ndërmarrë çdo veprim ndihmës ose të lidhur me veprimtarinë tregtare të Shoqërisë, në përputhje me ligjin.

Shoqëria nuk do të ushtrojë veprimtari që kërkon leje, liçencë ose autorizim të veçantë pa i përmbushur paraprakisht kushtet ligjore përkatëse, në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, dhe aktet nënligjore përkatëse.

Neni 3:

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë vendoset për një periudhë të pacaktuar kohore nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Neni 4:

Selia

(1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: : Rruga “Fadil Rada”, Numri i Pasurisë 6/668+1-18,

Zona Kadestrale Nr. 8150, Ap.18, Tiranë

(2) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon (nëse ka).

e-mail: enid.mero@gmail.com

Kreu II
KAPITALI, KONTRIBUTET E KAPITAL THEMELTAR,
SHPËRNDARJA E KUOTAVE ETJ.

Neni 5

Kapitali themeltar

- (1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (një qind mijë) Lekë. Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tij si më mëposhtë. Kontributi i kapitalit themeltar ka ndodhur si vijon:

Ortakët Themelues:

1. Z. *Enid Mero* - Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 88,000 Lekë (Tetë Dhjetë e Tetë mijë lekë) që përben 88% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Z. *Oni Brahimaj* - Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 12,000 Lekë (Dymbëdhjetë mijë lekë) që përben 12% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërise mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga asambleja e ortakëve e një eksperti kontabël të regjistruar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat mund t'iu transferohen palëve të treta tërësisht ose pjesërisht nëpërmjet:

- Kontributit në kapitalin themeltar;
- Blerjes - shitjes së kuotave;
- Trashgimisë;
- Dhurimit;
- Çfarëdo mjeti tjetër të parashikuar nga ligji.



Faqe 4

Pjesët e kapitalit themeltar janë të lira për transferim mes partnerëve, nëse nuk parashikohet ndryshe në Statut.

Pjesët e kapitalit bazik janë të lira për transferim përmes trashëgimisë.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të regjistruar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) shpërndarjen e fitimeve vjetore
- f) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- g) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- h) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- j) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- k) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.



Faqe 5

Secili ortak mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Vendimet e shumicës të Asamblese janë detyruese për ortakë që mungojnë ose janë kundër, por kanë të drejtën e ankimit në rastet, afatet dhe format e parashikuara nga ligji.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja duhet të thirret nepermjet njoftimit me leter rekomande që duhet t'u dërgohet ortakëve në adresen që rezulton në Librin e Ortakëve ose nëpermjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.


Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 80 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare “, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.



Faqe 6

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me 80% e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si dhe nëse janë dy ortak dhe njeri prej tyre zotëron mbi 50% mund të marri i vetëm vendime të vlefshme për çështjet më poshtë:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- k) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 12

Përgjithshmi nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.



Page 7

Neni 13
Administrimi

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit

Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.


Të dhënat e identifikimit dhe specimentet e nënshkrimit (mbiemrat, emrat, adresat):

» Xhoana Ferra, me Nr Personal J05624052B

» Adresa: Rruga “Fadil Rada”, Numri i Pasurisë 6/668+1-18, Zona Kadestrale Nr. 8150, Ap.18, Tiranë

Emer Mbiemer, Firm

Xhoana Ferra

Xhoana Ferra



Një Asamble e Përgjithshme do të mbahet për të vendosur delegimet e fuqisë midis Administratorëve, si dhe procedurat e kontrollit të brendshëm që do të zbatohen.

Neni 14
Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;




Page 8

dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratores janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithëshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brënda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brënda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Përgjegjësite e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare“, administratori detyrohet:



Faqe 9

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme:


a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.



Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV

VITI FINANCIAR-EKSPERTËT KONTABËL

Neni 16

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërise fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përgjatë vitit, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertët Kontabël

Nëse është e nevojshme apo të kërkohej nga ligji, kontrolli i pasqyrave financiare dhe librave të shoqërisë do t'i besohet një audituesi të autorizuar të emëruar në mënyrën e përcaktuar me ligj me të drejtë riemërimi.

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i regjistruar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Eksperti kontabel i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së njëjtë të emërimit.



Kreu V

PRISHJA – RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 18

Prishja dhe Likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërise mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “ Shoqëri në likuidim e sipër “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këte statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.



Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

U lexua, u nënshkrua dhe u firmos.

O R T A K Ë T

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Z. Enid MERO

Enid Mero


Z. Oni BRAHIMAJ


Oni Brahimaj